



UNIVERSITETI I SHKODRËS
«LUIGJ GURAKUQI»

RREGULLORE
E REVISTËS SHKENCORE
“Buletin shkencor” i USH-së

Shkodër, 2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2296 prot.

Shkodër, më 22.07.2021

V E N D I M

Nr. 240, datë 22.07.2021

"Për miratimin e Rregullores për Buletinin Shkencor"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38 pika 1, germa "d"; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa "r", në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021

Vendosi:

1. Miratimin e Rregullores për Buletinin Shkencor (bashkëlidhur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARË
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Neni 1

Natyra dhe qëllimi i botimit të revistës “Buletin shkencor”

- 1.1. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (në vijim USH) boton revistën shkencore “Buletin shkencor”, e cila është pronë e tij.
- 1.2. Buletin-i shkencor është revistë periodike njëvjeçare, e ndarë në seri të veçanta :
 - *seria e shkencave shoqërore*, që mbulon fushat gjuhësi, letërsi, histori, gjeografi etj.;
 - *seria e shkencave natyrore*, që mbulon fushat matematikë, fizikë, biologji, kimi, gjeografi fizike, shkenca mjekësore, shkenca të mjedisit etj.;
 - *seria e shkencave të edukimit*, që mbulon fushat didaktikë, psikologji, pedagogji edukimi, sociologji, histori e shkollës dhe e mendimit pedagogjik, probleme të përmbajtjes dhe të metodologjisë së mësimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit etj.;
 - *seria e shkencave ekonomike*, që mbulon fushat administrim-biznes, financë, kontabilitet, turizëm etj.;
 - *seria e shkencave juridike*, që mbulon fushën e drejtësisë, duke trajtuar probleme ligjore të lidhura ngushtë edhe me zbatimin e tyre në praktikë.
- 1.3. Me vendim të Senatit Akademik të USH-së mund të hapen edhe seri të tjera ose të mbyllen ato ekzistuese.
- 1.4. Ajo botohet në gjuhën shqipe dhe shoqërohet me një abstrakt në gjuhën angleze. Në rastin e autorëve të huaj artikulli mund të botohet në gjuhë të huaj i shoqëruar me abstraktin në gjuhën shqipe. Versioni online mund të publikohet në gjuhët shqipe dhe angleze.
- 1.5. Të drejtën për të botuar artikujt e tyre në këtë organ e kanë të gjithë pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të USH, ekspertët dhe specialistët e fushës, shqiptarë e të huaj, në rastet kur punimet e tyre përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë Rregullore.
Të drejtën për botim e kanë edhe doktorantët; me kusht që të kenë si bashkautor udhëheqësin e tyre shkencor.
- 1.6. Revista “Buletin shkencor” përfaqëson një vepër kolektive të botuar nën drejtimin e USH-së, që respekton të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to.

Neni 2

Organet drejtuese të revistës, përbërja dhe veprimtaria e tyre

- 2.1. Për botimin e revistës ngrihen redaksitë sipas serive përkatëse (të përmendura në nenin 1).
- 2.2. Drejtori i revistës është rektori i USH-së.
- 2.3. Redaksitë e serive, që janë organe vendimarrëse të përbëra nga 5-7 anëtarë, kanë në përbërjen e tyre kryeredaktorin, sekretarin shkencor dhe 3-5 përfaqësues të fushave të ndryshme. Të gjithë anëtarët duhet t'i përkasin kategorisë “Profesor” dhe të kenë përvojë të gjatë në veprimtarinë botuese. Në rastet kur nuk ka mjaftueshëm anëtarë të kategorisë “profesor”, për të plotësuar përbërjen, anëtari mund t'i përkasë kategorisë “lektor”.
- 2.4. Anëtarët e redaksisë duhet të përzgjidhen në mënyrë të tillë që të jenë përfaqësues nga të gjitha fushat e studimit.
- 2.5. Rektori i USH, në dakortësi me drejtuesin të njësisë kryesore, emëron kryeredaktorin.
- 2.6. Kryeredaktori, në bashkëpunim me drejtuesit e njësive kryesore, dhe kur është brenda një njësie kryesore pasi ka marrë mendimin e njësive bazë, propozon anëtarët e tjerë të redaksisë, të cilët miratohen nga rektori i USH.
- 2.7. Sekretari shkencor zgjidhet nga redaksia në mbledhjen e saj të parë.
- 2.8. Anëtarët e redaksisë kanë këto të drejta dhe detyrime:
 - të bëjnë përpjekje për të mbledhur materiale për botim;

- të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e redaksisë, duke siguruar jo vetëm pjesëmarrjen, por edhe aktivizimin e plotë në dhënien e mendimeve dhe në leximin e recensave apo edhe të materialeve që do të përzgjidhen për botim.
- të diskutojnë dhe të marrin vendime për miratimin e artikujve për botim, pasi të kenë shqyrtuar paraprakisht mendimet e recensentit për çdo artikull, në varësi të fushave që trajton materiali i paraqitur për botim.
- mungesa e pajustificuar në më shumë se dy mbledhje të njëpasnjëshme sjell zëvendësimin e tyre me një kandidat tjetër;
- kryeredaktori dhe sekretari shkencor kanë për detyrë të mbledhin nga anëtarët e tjerë të redaksisë materialet e rubrikës “*Jeta shkencore*” dhe ta përgatisin për botim atë.

Neni 3

Përmbajtja dhe struktura e revistës

- 3.1. Përmbajtja e revistës duhet të ketë të gjitha elementet e një reviste shkencore, për nga forma dhe përmbajtja.
- 3.2. Revista “*Buletin shkencor*” ka ISSN (International Standard Serial Number) 2221-6855.
- 3.3. Të gjitha seritë e “*Buletin-it shkencor*” dalin në format (176 x 250 mm) dhe shkrim të njëjtë (me përjashtim të kopertinës, me fontespice e ngjyrë karakteristike për çdo seri të veçantë).
- 3.4. Revista duhet të ketë, si rregull, strukturën e mëposhtme :
 - Rubrika 1 - Artikuj të karakterit teorik dhe të shkencave të zbatuara.
 - Rubrika 2 - Opinione e debat shkencor.
 - Rubrika 3 - Kritikë e bibliografi.
 - Rubrika 4 - Jeta shkencore.
- 3.5. Çdo artikull që botohet në revistën “*Buletin shkencor*” nuk duhet të jetë botuar më parë në libër, tekst, revistë apo çfarëdolloj botimi tjetër.
- 3.6. “*Buletin-i shkencor*” i USH-së del në jo më pak se 150 faqe dhe me një tirazh të përgjithshëm (të të gjitha serive) jo më pak se 600 kopje.
- 3.7. Me qëllim që të krijojë mundësinë e botimeve për sa më shumë autorë, duhet të zbatohet rregulli që një autor nuk mund të shkruajë më shumë se një artikull në një seri për çdo numër të revistës (me përjashtim të rasteve kur ai është autor i dytë në një artikull tjetër).

Neni 4

Rregullat të paraqitjes të artikujve shkencorë

- 4.1 Artikulli duhet të karakterizohet nga niveli shkencor bashkëkohor dhe të sjellë një kontribut teorik, eksperimental ose aplikativ, duke evidentuar elemente të qarta të origjinalitetit.
- 4.2 Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë të caktuar sipas fushës përkatëse dhe duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementet e mëposhtme:
 - në krye të artikullit të vendoset emri i autorit;
 - titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere;
 - artikulli, në varësi të tematikës që trajton ose serisë, mund të jetë i strukturuar në disa nënçështje. Në fund të artikullit mund të vendoset një nënçështje e veçantë me titull : sugjerime apo përfundime. Titujt e nënçështjeve të jenë me “**Bold**” dhe me shkrim “*italik*”.
 - artikulli duhet të jetë i shkruar në “*Time Neë Roman*”, 12, me “*hapësirë l*” dhe i gjithë teksti të jetë “*Justify-ed*”.

- Citimet (në formën e footnotes) duhet të bëhen në mënyrë kompjuterike, të jenë të shkruara në "Time Neë Roman", 10, në fund të çdo faqeje..
- datat në përbërje të artikullit (nëse ka të tilla) të shkruhen sipas modelit: dita – muaji – viti;
- çdo artikull duhet të shoqërohet me një abstrakt në gjuhën angleze;
- çdo artikull duhet të ketë të evidentuar bibliografinë, e cila vendoset në fund;
- shkrimet duhet të paraqiten si artikuj jo më shumë se 15 faqe dhe jo më pak se 5 faqe, përveç rubrikës "Kritikë e bibliografi", e cila mund të ketë edhe shkrime më të shkurtra;
- artikulli duhet të respektojë rregullat e drejtshkrimore dhe ato të pikëzimit.

Neni 5

Procedurat e përgatitjes dhe të botimit të revistës

- 5.1. Materialet për botim dorëzohen pranë sekretarit shkencor të redaksisë në formë të shtypur, si dhe dërgohen në formë digjitale në adresat përkatëse të redaksive (sipas serive).
- 5.2. Pranimi i artikujve protokollohet në redaksi.
- 5.3. Pranohen vetëm ato artikuj që janë në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje.
- 5.4. Redaksia në mbledhjen e saj cakton recensentët sipas fushave përkatëse. Për çdo artikull caktohet të paktën një recensent, i cili duhet të ketë njohuri të thelluara të fushës.
- 5.5. Recensentët japin mendimin e tyre me shkrim sipas formatit bashkëngjitur (*aneks 1*) pa u njohur me emrin e autorit..
- 5.6. Të gjitha punimet që pranohen për shqyrtim, së bashku me recensat, paraqiten dhe shqyrtohen në mbledhjen e redaksisë.
- 5.7. Redaksia merr vendim rast pas rasti për pranimin e artikujve për botim, për rikthimin e tyre për përpunim të mëtejshëm sipas vërejtjeve të recensentit apo i kthen si të pabotueshme.
- 5.8. Në çdo rast redaksia i njofton me shkrim autorët për vendimet që ka marrë.
- 5.9. Kur materiali i kthehet autorit për ripunim, redaksia në mbledhjen e radhës rishqyrton mendimin e recensentit për variantin e ri të përpunuar nga autori.
- 5.10. Autori mban përgjegjësi për përmbajtjen dhe nivelin shkencor të punimit. Ai mban përgjegjësi të plotë edhe në rastet e plagjiaturës.
- 5.11. Kopjet e artikujve të dorëzuara në redaksi nuk i kthehen autorit. Ato mbahen në dosjen e "Buletinit shkencor" në redaksinë përkatëse.
- 5.12. Redaksia mban përgjegjësi të plotë për cilësinë dhe për zbatimin e afateve kohore të përgatitjes së "Buletinit".
- 5.13. Brenda afateve të caktuara ajo e dorëzon dosjen e plotë me artikujt e miratuar për botim në formë të kompjuterizuar, shoqëruar me shkresë përcjellëse pranë Qendrës së Kulturës dhe të shtypshkrimit.
- 5.14. Qendra e kulturës dhe e shtypshkrimit, pasi bën rishikimin, redaktimin gjuhësor dhe formatimin përfundimtar të artikujve sipas formatit të revistës, i dërgon për botim pranë shtypshkronjës së USH.

Neni 6

Indeksimi i revistës

Redaksitë duhet të mundësojnë përfshirjen e serive në bazën e të dhënave kombëtare e ndërkombëtare të punimeve shkencore në mënyrë që ato të indeksohen nga platformat e indeksimit.

Neni 7
Financimi i revistës

- 6.1. Revista botohet nga USH me fonde që burojnë nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat e meta apo nga donacionet e ofruara.
- 6.2. Revista mund të shitet dhe të ardhurat e nxjerra të përdoren për të përballuar kostot direkte të shpenzimeve të kryera për këto publikime.
- 6.3. Kryeredaktori, sekretari shkencor, anëtarët e redaksive dhe recensentët mund të shpërblehen financiarisht në masa të caktuara nga USH sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 8
Shpërndarja e "Buletinit shkencor"

- 7.1. Sektori që mbulon kulturën dhe shtypshkrimin në USH në bashkëpunim me redaksitë përkatëse siguron shpërndarjen dhe/ose shitjen e revistës.
- 7.2. Sektori që mbulon kulturën dhe shtypshkrimin në USH, në bashkëpunim me redaksitë përkatëse dhe me Bibliotekën e USH, siguron shpërndarjen revistës për shkëmbim me revista të tjera shkencore apo Biblioteka brenda e jashtë vendit.
- 7.2. Ky sektor ka detyrimin që të dorëzojë 5 kopje të serive të "Buletinit shkencor" pranë Bibliotekës Kombëtare, si dhe nga 3 (tri) kopje pranë Bibliotekës së qytetit dhe Bibliotekës së USH-së.
- 7.3. Rektori, me propozim të kryeredaktorëve të redaksive, miraton listën e shpërndarjes falas të "Buletinit shkencor" sipas serive.
- 7.4. Autorëve të artikujve u jepet një kopje e "Buletinit".

Neni 9

Kjo "Rregullore" e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga viti 2021.

Neni 10

Të drejtën e patjetërsueshme për interpretimin e kësaj Rregulloreje e ka Rektori i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Miratuar me vendimin nr. 240, datë 22.07.2021 të Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".



KRYETARI

Prof. dr. Sh. P. G. G. G.